



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 12.2 pika d), nenit 73, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28 të datës 4 qershor të vitit 2008) dhe në zbatim të nenit 29,30 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014, dhe nenit 3 të udhëzimit administrative nr. 2008/10 për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në komuna, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në mbledhjen e mbajtur me 30.04.2015 miraton këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV TË EKSPERTEVE TË
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE SHPALLJEN E KONURSIT PËR ANËTARËSIM
NË KOMITET

1. Me këtë Vendim themelohet Komiteti Konsultativ i eksperteve të planifikimit hapësinor.
2. Komiteti Konsultativ i eksperteve të planifikimit hapësinor kryen këto detyra:
 - 2.1 Jep mendime, propozime dhe vërejtje në propozimet e kryetarit të Komunës lidhur me dokumentet e planifikimit hapësinor (Planit zhvillimor komunal, Planit zhvillimor urban dhe Planeve rregulluese urbane) dhe dokumentet tjera të cilat të cilat i miraton Kuvendin e Komunës.
 - 2.2 Shqyrton dhe propozon zgjidhje përkatëse për problemet e identifikuar të dokumenteve për strategjitë zhvillimore.
 - 2.3 Përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit hapësinor të cilat në pajtim me dispozitat ligjore miratohen në Kuvendin e Komunës.
 - 2.4 Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga fusha e planifikimit hapësinor.
3. Komiteti konsultativ i eksperteve do të ketë 7 anëtarë ku anëtarësimi i tyre në komitet bëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare të fushës përkatëse.
4. Kuvendi autorizon Udhëheqësin e Njesisë së Kuvendit që të shpallë konkursin për anëtarësim në komitetin e eksperteve të planifikimit hapësinor.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

01.Nr.016-41883
Gjiçan, më 30.04.2015.

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku-Rexhepi